



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria e Arsimit
Uprava za Obrazovanje//Department of Education

Nr.prot:05/ 484

Datë:17.06.2025

Duke u bazuar në nenin 62, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, bazuar në Ligjin Nr.02/L-052 mbi Edukimin Parashkollor, në Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, në Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr.03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, në Bazë të Rregullorës Komunale për Organizimin e Punës në Arsimin Parauniversitar

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS

**PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR
“ALBIONA ASLLANI” NË MUZEQINË PËR VITIN SHKOLLOR 2025/2026**

Regjistrimi i fëmijëve në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Muzeqinë rr “Maliq Hoxha” nr.67, do të bëhet duke u bazuar në Kriteret e Regjistrimit të përcaktuara nga DKA përmes vendimit nr.prot.05/483 të datës 17.06.2025 i cili do t'i bashkangjitet këtij konkursi.

Vendet e lira për regjistrim në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Muzeqinë për vitin shkollor 2025/2026:

Nr i klasave	Grupmoshat	Nr i fëmijëve
1 klasë (dhomë)	Grupi i Çerdhes 9 muaj deri 2 vjeç	4 fëmijë
1 klasë (dhomë)	Grupi i Çerdhes 2 deri në 3 vjeç	2 fëmijë
Gjithsej		6 fëmijë

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

1. Ekstrakti i lindjes së fëmijës (kopje)
2. Libreza e imunitetit/vaksinimit (kopje)
3. Dëshmia nga mjeku (mjeku pediatër ose mjekut familjar) për gjendjen shëndetësore të fëmijës (origjinale)
4. Kontrata e prindërve që janë në marrëdhënie pune së bashku me pasqyrën e trustit për 6 mujorin e fundit (kopje)
5. Faturë e shërbimeve komunale, jo më e vjetër se gjashtë muaj

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit përkatësisht nga data 18. 6. 2025 deri më datë 2. 7. 2025

Aplikacioni dhe gjithë dokumentacioni i nevojshëm merren dhe dorëzohen çdo ditë pune në objektin e Institucionit Parashkollor “Albiona Asllani” në Muzeqinë, rr”Maliq Hoxha” nr.67, nga ora 9:00 deri në ora 15:00.

Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohet



Drejtoresha e DKA-së
Yllka Fejzullahu